

Çfarë duhet të bëjmë

Praktiko



"Përkulu, mbulohu dhe qëndro" nën orendi të forta si tavolina, në shtëpi me familjen tuaj, në shkollë me shokët dhe në vendin e punës me punonjësit e tjerë.

Numëroni deri në 60 sekonda. Kjo do t'u ndihmojë për të ruajtur gjakftohësinë gjatë tërmetit.

Përpara tërmetit

Mëso se si

Të japësh ndihmën e parë.

Të ndihmosh të moshuarit dhe invalidët
Kontakto Kryqin e Kuq të Kosovës dhe në Prishtinë dhe në rrethe.

Të kërkojë ndihmë për emergjencë ekstreme
Të fikësh zjarre.

Kontakto Zjarrfikësit dhe Urgjencën

Të shpëtosh njerëz të bllokuar nën rrënoja
Kontakto bazën e mbrojtjes Civile dhe Stacionin e zjarrfikësit



Pajisjet rezervë të urgjencës

-Përgatitu për të mbijetuar për të paktën tre ditë.

Përgatit dhe vendos menjëherë një vend të caktuar dhe të thatë, në çdo kohë përpara një tërmeti.

-Bonbol gazi zjarrfikës.

-Disa lloje ilaçesh qetësuese dhe të domosdoshme për ju, familjarët apo shokët tuaj.

-Kutinë e ndihmës së shpejtë.

-Ujë për çdo pjesëtar familjeje për të paktën tre ditë (dhe rrjetin për hapjen e tyre)

-Celësa për mbylljen e shpërndarësve të gazit dhe të ujit.



SI TA BËJMË LAJMËRIMIN ?

-Prezantohu

-Fol kurtë mbi ngjarjen e ndodhur

-Trego saktë vendin e ngjarjes

-Trego numrin e telefonit prej nga bëni thirrjen

-Mos e ndërpre lidhjen pa e dhënë informacionin e plotë

NUMRAT ME RËNDËSI NË RAST EMERGJENCE

193 ZJARRFIKSAT

112 QENDRA REGJONALE E ALARMIMIT

192 POLICIA

Kryqi i Kuq i Kosovës


Në bazë të Parimeve Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuq: Humaniteti, Paanësia, Neutraliteti, Pavarësia, Vullnetarizmi, Uniteti dhe Universaliteti. përpiqet të lehtësojë vuajtjet njerëzore të individëve dhe bashkësive të rrezikuara përmes programeve të fokusuara, prioritare dhe të qëndrueshme si ndihmë e autoriteteve qendrore dhe lokale.



PROGRAMI I MENAXHIMIT TË FATKEQËSIVE

TËRMETET ... A JE I PËRGATITUR

KËSHILLA
Për vetëmbrojtje



PLANI I MBROJTJES NGA TËRMETET

Siguro vendin ku jeton dhe punon

Përgatit, shkollën dhe vendin e punës në mënyrë të tillë që të gjithë orënditë, si: raftet, bibliotekat e librave, pikturat apo tabelat të jenë të fiksuara në mur dhe orënditë e tjera të vendosura përgjatë tyre (p.sh. në korridore).

Kjo do t'u ndihmojë të lëvizni më lehtë në këto ambiente në rast tërmeti.

Përcakto vendet më të rrezikshme

Përcakto vendet më të rrezikshme në secilin ambient, pranë dritareve, bibliotekës së librave, apo objekteve të tjera të cilat mund të bien nga lëkundjet e tërmetit.

Fikso të gjitha këto objekte dhe instalimet elektrike, të gazit dhe ujit sa më mirë në mur.



Përcakto vendin më të sigurtë

Përcakto vendin më të sigurt në shtëpi, shkollë dhe vendin e punës larg prej objekteve të rënda, instalimeve elektrike, kalldajave apo furrave, apo bibliotekave të hapura.

Përgatit një plan dhe përzgjidh një vend



Përgatit një plan dhe përzgjidh një vend të sigurt jashtë ambientit të shtëpisë, shkollës, qendrës së punës apo brenda tyre në vende të siguruara më parë, në të cilin mund të takoheni me pjesëtarët e tjerë të familjes, shokët e shkollës apo punonjësit e tjerë, pas tërmetit.

Mëso vendin e çelësve qendror dhe si mbyllën ato

Mëso ku ndodhen dhe si mund të mbyllësh çelësat qendrorë të energjisë elektrike, ujit si dhe rubinetin e gazit.

Nëse je brenda

Qëndro brenda deri sa lëkundjet të pushojnë. Pjesa më e madhe e plagosjeve gjatë një tërmeti ndodhin kur njerëzit preken nga objekte që bien nga lëkundjet, në momentin e daljes apo hyrjes në ndërtesa.



Përkulu përtokë dhe mbrohu nën një tavolinë, apo ndonjë objekt tjetër të fortë. Qëndro aty dhe përgatitu të lëvizësh me të, nëse është e nevojshme.

Nëse pranë teje nuk ndodhet një tavolinë, mbulo fytyrën dhe kokën me krahë, përkulu e mbështetu në një mur të brendshëm mbajtës. Qëndro nën kasën e një dërrë të gjerë e të fortë në pozicionin e treguar në figurë.



Nëse ndodhesh në kuzhinë, largohu nga frigoriferi, sobat, oxhaku apo dollapet dhe dritaret, të cilat mund të bien dhe t'u dëmtojnë.

Qendro e qetë dhe jepju kurajo të tjerëve.

Nëse ndodhesh jashtë



Zhvendosuhet në një ambient të hapur, larg prej pemëve, tabelave, ndërtesave, telave elektrike apo ato të telefonit.

Nëse ndodhesh në një mabient publik

(psh. në një supermarket të mbyllur ku ka njerëz) Ruaj gjakftohtësinë; mos vrapo për të dalë; qëndro larg nga raftet dhe sendet.

Nëse je duke ngarë makinën

Pa u nxituar, qëndro në një krah të rrugës. Shmang qëndrimin nën ura, mbikalime, pemë, fenerët apo tabelat treguese. Qëndro brenda derisa lëkundjet të përfundojnë.



Kontrollo

Do të jesh në gjendje të kujdesesh për të tjerët vetëm në rast se nuk je plagosur gjatë tërmetit, apo pasi ke marrë ndihmën e parë. Mos lëviz nga vendi personat e plagosur, përveçse në rastet kur ata janë në rrezik për t'u dëmtuar më rëndë.

Kontrollo për t'u siguruar

Oxhakët, sobat me korrent ose me gaz duke qëndruar larg tyre.

Depozitat e gazit (mbyll rubinetin kryesor të gazit nëse mendon se mund të ketë rrjedhje apo dallohet nga era).

Linjat elektrike dhe tubacionet e tjera të dëmtuara (mbyll çelësin kryesor të energjisë elektrike, qëndro larg prej tyre edhe në rastet kur duket sikur nuk ka rrymë)

Pastro materialet e rrezikshme apo ilaçet, të cilat mund të jenë shpërndarë gjatë lëkundjeve.



Nëse ndodhesh i bllokuar në një ndërtesë

Ngjitu në katin më të lartë të mundshëm dhe kërko ndihmë. Nëse je i bllokuar, qëndro pa lëvizur dhe skuadrat e kërkimit shpëtimit dhe zjarrfikësit.

Prit lëkundjet tjera pas goditjes kryesore

Përdor elektrik dore apo fener me bateri.

Mos përdor shkrepsë, çakmak, qirinj deri sa të sigurohesh që nuk ka rrjedhje gazi.



Përdor radion me bateri për t'u informuar rreth situatës

Mos blloko rrugët dhe ambientet e tjera, për të mundësuar kalimin me lehtësi të mjeteve të urgjencës.

Bashkëpunohet me punonjësit e rendit.

Bashkohu

Me skuadrat e shpëtimit dhe ndiq urdhrat e tyre.

Ndihmo vullnetarisht brigadat e zjarrfikësve, skuadrat e kërkimit shpëtimit apo organizatat humanitare.